



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 28.01.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “QËNDËR
MULTIFUNKSIONALE TEPELENË”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË TEPELENË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Qëndër multifunksionale Tepelenë”, me vendndodhje në Bashkinë Tepelenë, me subjekt zhvillues Ministrinë së Turizmit dhe Mjedisit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullore së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tepelenë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 07/03 2025